



Duke u bazuar në nenin 17 nen pikën r) dhe nenit 40.alineja 2 pika l) të Ligjit për Vetqeverisjen Lokale në Republikën e Kosovës nr.03/L-040,Ligjin Për Financat Publike dhe Pergjegjësitë nr.05/L-007 I ndryshuar dhe plotsuar Nr.03/L-048, nenit 10 të Rregullores për Subvencione dhe Transfere /2015, 40 alineja 2 nen pikën 3) të Statutit të Komunës, Rekomandimeve të Komitetit për Politikë dhe Financa të 14.06.2021, me kërkesën e Shoqatës së Invalidve të Luftës se UÇK-së 01nr.553-17986/21 të datës 08.06.2021, Kuvendi I Komunës së Klinës në seancën e VI –të rregullt për vitin 2021, të mbajtur me dt.25.06.2021,mori këtë:

V E N D I M

Për ndarjen e mjeteve buxhetore për mbarrëvajtjen e punëve dhe aktiviteteve të Shoqatës së Invalidve të Luftës se UÇK-së dega në Klinë

I.

Miratohet vendimi për ndarje të mjeteve buxhetore Shoqatës së Invalidve të Luftës se të UÇK-së dega në Klinë në shumën prej 1.000(njëmij €).

II.

Mjetet ndahenë nga kategoria e subvencioneve në shumë prej 1,000€ (njëmij €) ndersa pjesa e mbetur prej 1.930€ (njëmij e nëndqind e tridhjet €) do të ndahet pas rishiqimit të buxhetit për vitin 2021.

III.

Ky vendim hynë në fuqi pas aprovimit nga Kuvendi Komunal i Klinës dhe 7 ditë pas publikimit në ëeb faqe zyrtare të Komunës.

Me këtë vendim njoftohën: Kryetari i Komunës, Drejtorija e FEZH, Parashtruesi i kërkesës-Shoqatës së Invalidve të Luftës së UÇK-së dhe Arkivi.

KUVENDI I KOMUNËS SË KLINË

01Nr. 06-21089 /21
Klinë, me 01.07, /21



Kryesuesi,
Fadil Gashi